



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.2

11 janar

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MF nr.1, datë 11.1.2008	Për tatimin mbi të ardhurat	7
Udhëzim i MF nr.2, datë 11.1.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar	14
Udhëzim i MF nr.3, datë 11.1.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat”, i ndryshuar	19

UDHËZIM
Nr.1, datë 11.1.2008

PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Të ardhurat e personave fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8 milionë lekë dhe jo më pak se 2 milionë lekë janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale.

2. Shpenzime të panjohura për efekte fiskale, përveç atyre të përmendura në ligj nuk do të njihen shpenzimet për paga, shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me të ardhurat në marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë dhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar. Përrjashtimisht nga ky rregull bëjnë pjesë ato subjekte të cilat ushtrojnë veprimtari në zonat të cilat nuk mbulohen nga rrjeti bankar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.802, datë 21.11.2007 “Për përcaktimin e rasteve të shpenzimeve të panjohura, për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm”.

Gjithashtu, përrjashtimisht nga ky rregull bëjnë pjesë ato kategori blerjesh me para në dorë, përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.632, datë 21.11.2007 “Për përcaktimin e rasteve të përrjashtimit të pagesave *cash* për blerje mallrash dhe shërbimesh”, nga individë të përrgjistruar në organet tatimore dhe që ushtrojnë veprimtari ekonomike në fushën e grumbullimit dhe të përrgatitjes për riciklim të mbeturinave dhe mbetjeve, metalike e jometalike (letër, gomë, sende plastike, tekstile, qelq etj.), grumbullimi dhe përrpunimi i bimëve mjekësore, grumbullimi dhe përrpunimi i produkteve bujqësore, blegtorale dhe të peshkut.

3. Për të gjitha rastet e tjera, tatimpaguesit do t’i njihen për efekt shpenzimesh vetëm ato pagesa me lekë në dorë (*cash*) për blerje mallrash e shërbimesh me vlerë deri në shumën 300 000 lekë për çdo blerje, por jo më shumë se 10 për qind të totalit të blerjeve gjatë periudhës tatimore. Mbi këtë shumë, për të qenë të njohura si shpenzime për efekte fiskale, pagesat duhet të kalojnë nëpërmjet xhirimeve në llogarinë bankare.

DOKUMENTACIONI QË PËRDORET DHE MBAJTJA E REGJISTRIMEVE TË TATIMPAGUESVE TË TAKSËS VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL ME QARKULLIM MBI 2 DERI NË 8 MILIONË LEKË NË VIT

4. Për çdo vendndodhje të veprimtarisë, tatimpaguesi duhet të mbajë një seri regjistrimesh më vete dhe dokumentacionin që lidhet me atë vendndodhje biznesi.

4.1 Për qëllimet e këtij tatimi, tatimpaguesi duhet të mbajë regjistrimet dhe dokumentet që vijnë:

a) dokumentet e blerjes, ku përrfshihen fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore, dëftesa tatimore etj., për të vërtetuar blerjet e kryera;

b) dokumentet e shitjes ku përrfshihen, fatura e thjeshtë tatimore, dëftesa tatimore dhe përrmbledhëset ditore të arkës regjistruese (për shitjet me arkë);

c) librin e blerjeve;

d) librin e shitjeve;

e) librin e inventarit të gjendjes së mallrave në fund të vitit;

f) librin e shpenzimeve dhe të ardhurave;

g) librin e aktiveve të biznesit.

4.2 Të gjitha këto dokumente do të jenë në përrputhje me modelet që i bashkëngjiten këtij udhëzimi.

4.3 Në fund të periudhës tatimore, subjektet e biznesit të vogël, me qarkullimin vjetor mbi 2 deri 8 milionë lekë në vit detyrohen të deklarojnë në organin tatimor (degën e tatimeve të rrethit përrkatës) inventarin e gjendjes së mallrave në fund të periudhës sipas njërës prej metodave të përraktuara në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004. Modeli i paraqitjes së inventarit të mallrave të biznesit në fund të periudhës tatimore (31 dhjetor të vitit financiar të mbyllur), i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

4.4 Tatimpaguesit e taksës vendore mbi biznesin e vogël me qarkullim vjetor të mallrave të shitura apo të shërbimeve të ofruara mbi 2 deri në 8 milionë lekë në vit, detyrohen të plotësojnë e dorëzojnë në një

nga bankat me të cilat vepron organi tatimor formularin e deklarimit të të ardhurave vjetore. Formulari i deklarimit të të ardhurave vjetore dhe fatura e thjeshtë tatimore prodhohen dhe u shpërndahen tatimpaguesve të taksës vendore mbi biznesin e vogël nga organi tatimor. Dokumentacioni bashkëngjitur udhëzimit paraqitet nga subjekti në çdo rast kontrolli të ushtruar nga organet tatimore. Ato duhet të garantojnë saktësinë e të dhënave të kërkuara.

4.5 Organet e pushtetit vendor i dorëzojnë brenda muajit janar 2008, degëve të tatimeve listën e tatimpaguesve të taksës vendore mbi biznesin e vogël, të cilët në bazë të deklaratës parashikuese të qarkullimit apo në bazë të vlerësimeve të bëra nga zyra e taksave në bashki, apo komunë, rezultojnë me një vlerësim qarkullimi 2 deri 8 milionë lekë për vitin kalendarik.

KUNDËRVAJTJET

5. Konsiderohen kundërvajtje administrative mospasqyrimi i saktë i të ardhurave dhe shpenzimeve nga veprimtaria me efekt në të ardhurat e tatueshme dhe dënohet, përveç detyrimit edhe me një dënim të barabartë me shumën e këtij detyrimi.

5.1 Falsifikimi i të dhënave dhe i dokumentacionit për të ardhurat dhe shpenzimet dënohet, përveç detyrimit edhe me një dënim të barabartë me shumën e këtij detyrimi.

5.2 Mosparaqitja brenda afatit kohor e deklaratës tatimore vjetore dënohet me një gjobë në masën 10 000 lekë për çdo muaj vonesë.

5.3 Për mosrespektim të afatit të përcaktuar në këtë ligj për pagimin e tatimit, personat përgjegjës paguajnë një interes për pagesë të vonuar, në përputhje me ligjin e procedurave tatimore në Republikën e Shqipërisë.

5.4 Mosmbajtja e rregullt e regjistrimeve të inventarit dënohet me një gjobë në masën 10 000 lekë.

5.5 Për mosrespektimin e afatit të përcaktuar në këtë ligj, për pagimin e tatimit personat, përgjegjës paguajnë interesa për pagesë të vonuar, në përputhje me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

5.6 Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

DISPOZITA KALIMTARE

6. Organet tatimore, kontrollojnë subjektet e taksës vendore me qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit për mbajtjen e rregullt e të saktë të dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim. Ato kontrollojnë afishimin e çmimeve, lëshimin e dokumentacionit për çdo shitblerje nëpërmjet faturave të thjeshta tatimore, kuponeve nga regjistruarit e arkave me memorie fiskale apo dëftesave tatimore, si dhe kryejnë verifikime mbi saktësinë e inventarëve të paraqitur nga deklarimi i subjekteve, por edhe mbështetjen e tyre me fatura blerjeje.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1 janari 2008.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode

Libri i shitjeve per muajinviti

Tatimpaguesi

NIPT

Aktivitet.....

[illegible]

* Sheno vleren 0 (zero) daten kur nuk ke patur asnje shitje

EMER

MBIEMER

Libri i blerjeve per muajinviti

Tatimpaguesi.....

NIPT

Aktivitet.....

[illegible]

* Sheno vleren 0 (zero) daten kur nuk ke patur asnje blerje

EMER

MBIEMER

Inventari fizik i mallrave dhe materialeve i datesviti	
Tatimpaguesi.....	
NIPT	
Aktivitet.....	

NIPT

Aktivitet.....

* Vlera rezulton duke shumezuar sasine qe eshte gjendje te mallit apo materialit me cmimin qe ai ka ne faturen me te fundit te blerjes	
EMER	MBIEMER

* Vlera rezulton duke shumezuar sasine qe eshte gjendje te mallit apo materialit me cmimin qe ai ka ne faturen me te fundit te blerjes

[illegible]

Te Ardhurat e Shpenzimet per vitin

Tatimpaguesi.....

NIPT

Aktivitet.....

(Llogaria e Fitimeve dhe e Humbjeve)

<i>Nr.</i>	SHPENZIMET	<i>Vlefte*</i> <i>ne leke</i>	<i>Nr.</i>	TE ARDHURAT	<i>Vlefte*</i> <i>ne leke</i>
1	Kostua e Lendeve te Para dhe Materialeve te shitura (a-b)		1	Nga Shitja e Produkteve te Prodhimit te Vete	
a	Blerje lende te para e materiale gjate vitit		2	Nga shitja e Sherbimeve	
b	Gjendje nga inventari		3	Nga shitja e Mallrave	
2	Kostua e mallrave te shitura (a-b)		4	Nga shitja e Materialeve	
a	Blerje mallra gjate vitit		5	Nga shitja e aktiveve	
b	Gjendje nga inventari		6	Arketimi i debitoreve te shlyer	
3	Shpenzime ne funksion te aktivitetit		7	Interesa te Fituara dhe te Ngjashme	
a	Energjia, uji, telefoni, faksi, interneti		8	Diferenca pozitive nga Kembimi valutor	
b	Shpenzime te qarkullimit te mallit e transportit			TOTALI I TE ARDHURAVE (1+2+3+4+5+6+7+8)	
c	Benzine/Nafte/Gaz				
d	Qera ambjenti				
e	Pagesa te kreditoreve per shlyerje dhe huave afatshkurtra				
f	Interesa te Paguara dhe komisione bankare			REZULTATI (TE ARDHURA - SHPENZIME) ME:	
g	Diferenca Negative nga kembimi valutor				
h	Taksa Doganore		A	FITIM	
i	Shpenzime administrative, mirembajtje dhe te tjera			TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN (10 %)	
4	Shpenzime per pagat			FITIMI MBAS TATIMIT	
a	Pagat			PAGUAR TATIM PARADHENIE NE TREMUJORE	
b	Sigurime shogerore dhe te ngjashme			SHUMA PER TU DERDHUR	
5	Amortizimi i Aktiveve				
	TOTALI I SHPENZIMEVE (1+2+3+4+5)		B	HUMBJE	

* ne shitje dhe blerje do te shenohet vlera bruto e faturuar

INSPEKTORI KONTROLLUES
(Emri Mbiemri Firma)

PERSONI VETEDeKLARUES
(Emri Mbiemri Firma Vula)

UDHËZIM
Nr.2, datë 11.1.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 30.1.2006 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të neneve 58.1, 58.2, 58.3, 58.4 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Pas pikës 7.9.3 të udhëzimit, shtohet pika 7.9.4 “Lista e produkteve të përfshira në skemën e kompensimit për fermerët” me përmbajtje:

7.9.4 Lista e produkteve të përfshira në skemën e kompensimit për fermerët

Fermerët, të cilët në kuadër të veprimtarisë së kryer prej tyre, në një nga fushat e prodhimit të produkteve bujqësore e blegtorale, furnizojnë një person të tatueshëm sipas kuptimit të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, përfitojnë një kompensim kundrejt furnizimeve të kryera, sipas skemës së kompensimit të akorduar.

Lista e produkteve për të cilat zbatohet skema e kompensimit është si më poshtë:

A. Produkte bujqësore

- produkte bujqësore të përgjithshme;
- bimë zbukuruese dhe lulet, të natyrës ose të serave;
- prodhimi i kërpudhave;
- prodhimi i fidanishteve (kultivimin e pemëve të reja për shitje), farave;
- produkte medicinale.

B. Produkte blegtorale

- qumësht dhe nënprodukte të qumështit.

C. Të tjera

- mbarështim i bagëtive;
- mbarështim i shpendëve;
- mbarështim i lepujve;
- mbarështim i bletëve;
- mbarështim i krimbit të mëndafshit;
- mbarështim i kërmillit.

Fermerët, përfitues të skemës së kompensimit dhe që janë të pajisur me një kod personal lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të kenë kartën e fermerit, bashkëlidhur këtij udhëzimi.”.

2.Pika 9.1 “Libri i blerjeve” ndryshohet me përmbajtjen, si më poshtë:

“9.1 Libri i blerjeve

Libri i blerjeve është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm. Forma dhe përmbajtja e tij është sipas formularit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ai duhet të tregojë në faqen e parë numrin e identifikimit dhe emrin e personit. Të gjitha faqet duhet të kenë numër rendor. Libri plotësohet çdo ditë. Në të regjistrohen për çdo transaksion furnizuesi dhe të dhënat e faturës që paraqet transaksionin.

Në këtë libër regjistrohen data e lëshimit të faturës, numri rendor i faturës, numri serial i shtypur nga shtypshkronja ose nga tatimpagues, i kur i lejohet, të dhënat e deklaratës së importit, emri i shitësit dhe numri i identifikimit tatimor të tij.

Blerjet regjistrohen në vlerë totale, e cila përfshin edhe TVSH-në (në qoftë se ka), si dhe të ndara në blerje me TVSH dhe në blerje pa TVSH. Blerjet me TVSH regjistrohen të ndara në importe dhe blerje brenda vendit.

Për çdo blerje me TVSH personi regjistron vlerën e tatueshme dhe TVSH-në që i korrespondon kësaj blerjeje.

Për çdo blerje nga fermerët, sipas skemës së paraqitur në nenet 58.1, 58.2, 58.3, 58.4 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, personi regjistron vlerën e mallit të blerë te fermerët. Në një kolonë të veçantë, regjistrohet kompensimi i paguar fermerit, si produkt i vlerës së mallit të blerë me përqindjen e kompensimit.

Në fund të librit të blerjeve janë fletët e inventarit, të cilat përdoren për të pasqyruar inventarin e mallrave në fund të vitit.

Një kopje e regjistrimeve mujore në librin e blerjeve paraqitet në degën e tatimeve brenda datës 14 të çdo muaji.”.

3. Në zbatim të pikës 10.1 “Deklarata dhe pagesa e TVSH-së”, formulari ekzistues i deklarimit dhe pagesës shfuqizohet dhe zëvendësohet me formularin e paraqitur bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Pas pikës 19.6 të udhëzimit, shtohet pika 19.7 “Dënime për shkelje të skemës së kompensimit të fermerëve”, me përmbajtje:

“Në qoftë se fatura e lëshuar nga blerësi, person i tatueshëm, nuk përmban të gjitha të dhënat që janë të përcaktuara në nenin 58.4 të ligjit, personi i tatueshëm nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin e paraqitur në të dhe, detyrohet të paguajë një dënim të barabartë me vlerën e kompensimit, por jo më të vogël se 10 000 lekë.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1 janari 2008.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Karta e Fermerit

Pjesa e perparme e kartes:

MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT								
KARTË E FERMERIT								
DRBUMK _____								
Data e lëshimit:								
<table border="1"><tr><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>0</td><td>0</td><td>8</td></tr></table>	0	1	0	1	2	0	0	8
0	1	0	1	2	0	0	8	

Pjesa e mbrapme e kartes:

Emri dhe Mbiemri _____								
Rrethi _____								
Komuna _____								
Fshati _____								
Kodi vetiak:								
<table border="1"><tr><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td></tr></table>								
Drejtori DRBUMK	Fermeri							
_____	_____							
Nënshkrimi dhe vula	Nënshkrimi							

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESES SE TVSH

Numri i Vendosijes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)



(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial:

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):(3)

Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:

(4)

Emri Mbiemri i Personit Fizik:

(5)

Adresa:

(6)

Qyteti/Komuna/Rrethi:

(7)

Numri Telefonit:

Lajmeroni nese informacioni i mesiperm eshte jo i plotë ose ka ndryshuar

☐ **[8] Shenoni 'X' nqs gjate muajit nuk eshte bere asnje transakcion. Vendosi Dati, Firmosni dhe dorezoni Deklaraten.**

TVSH e llogaritur për muajin :

(9) Shitje të përjashtuara

(10) Eksporte

(11) Shitjet e tatueshme

Vlera e tatueshme

TVSH i llogaritur

(9)	
(10)	
(11)	(12)

TVSH e paguar për muajin :

(13) Blerje të përjashtuara e me TVSH jo të zbritshme

(14) Importe

(16) Blerje nga furnitore vendas

(18) Blerje nga fermeret vendas

Vlera e tatueshme

TVSH i zbritshëm

(13)	
(14)	(15)
(16)	(17)
(18)	(19)

Saktësime.

(20) TVSH i zbritshëm, mbartur nga muaji kaluar

(21) Kërkesë rimbursimi i tepricës së TVSH së zbritshme nga muaji kaluar

(22) Gjendja TVSH së zbritshme nga muaji kaluar ((20)-(21))

(23) Totali i TVSH së zbritshme për muajin ((15)+(17)+(19)+(22))

(24) Teprica e TVSH të zbritshëm ((23)-(12)) nqs (23) > (12)
(Të mbartet në muajin pasardhës)

(25) TVSH i DETYRUESHËM PER TU PAGUAR ((12)-(23)) nqs (12) > (23)

(26) Gjoha për vonesa në Pagesë/Dorëzim deklarate

(27) TOTALI PER TU PAGUAR

(20)	
(21)	
	TVSH i zbritshëm
	(22)
	(23)
(24)	
	(25)
	(26)
	(27)

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem - Deklaroj nen pergjegjesine time qe informacioni i mesiperm eshte i plotë dhe i saktë.

PAGESA

Vetem per perdorim zyrtar



Leke



Xhirim



Cek



(28) SHUMA E PAGUAR:

(28)

Data , Vula e Bankes dhe nënshkrimi i nëpunësve te bankes

**Originali - Dega e Tatimeve
Kopja - Personi i Tatueshem**

Periudha e deklaruar

1. Numri serial perdoret nga Dega e Tatimeve dhe sherben per te azhurnuar regjistrimet tuaja kur paraqitet deklarata
2. Periudha Tatimore eshte muaji i paraqitur nga dita e pare deri ne ditën e fundit. Te gjitha transakcionet (Shitjet, Blerjet dhe sakesimet) te kryera gjate kesaj periudhe duhet te perfshihen ne kete deklarate.

Hollesi te Personit te Tatueshem

3. Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT) eshte numri i vetem qe ju perfaqeson ju ne te gjitha marredheniet me Degen e Tatimeve. Ju duhet ta vendosni NIPT-in tuaj ne te gjitha faturat.

4. Emri Tregtar i Personit te Tatueshem eshte emri me te cilin ju paraqitni veprimtarine tuaj dhe qe tregohet ne certifikaten tuaj te NIPT-it

5. Emri, Mbiemri i Personit Fizik vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga nje Person Fizik dhe nuk ka emer tregtar

6. Adresa tregohet per vendin kryesor te ushtrimit te veprimtarise tuaj ekonomike. Kjo adrese eshte e treguar edhe ne certifikaten tuaj te NIPT-it.

7. Numri i Telefonit tregon numrin e telefonit ne vendin kryesor te ushtrimit te veprimtarise tuaj ekonomike.

Shenimi. Nqs ndonje nga treguesit e rubrikave 4, 5, 6, 7 ka ndryshuar, lutemi paraqitni informacionin e ri.

Mungese veprimtarie per muajin

8. Nqs ju nuk keni kryer asnje tip transakcioni gjate muajit, shënoni një "X" ne kutinë 8. Asnjë informacion shtesë nuk ju kërkohet vese t'i vendosni datën deklarates, ta firmosni atë, ta paraqitni në bankë sic veproni me pagesat normale te TVSH.

Shitjet tuaja (Qarkullimi) për muajin

9. Nga kolona "Shitje të përjashtuara" e Librit tuaj të Shitjeve, nxirri totalin e të gjithë shitjeve të përjashtuara të muajit dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale të shitjeve të përjashtuara në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 9 të Deklaratës tuaj. Shitjet e Përjashtuara nuk i nënshtrohen TVSH.

10. Nga kolona "Eksporte" e Librit tuaj të Shitjeve, nxirri totalin e të gjithë eksporteve të bëra për muajin dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale të eksporteve në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 10 të Deklaratës tuaj. Eksportet tatohen me 0%.

11. Nga kolona "Vlera e Tatueshme" e Librit tuaj të Shitjeve, nxirri totalin e të gjitha shitjeve të bëra gjatë muajit dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale të vlerës së tatueshme në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 11 të Deklaratës tuaj. Shitjet e Tatueshme i nënshtrohen një tatimi prej 20%.

12. Nga kolona 12 "Shitjet e Tatueshme-TVSH", e Librit tuaj të Shitjeve, nxirri totalin e këtyre shitjeve për muajin dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale tvsh e shitjeve të tatueshme në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 12 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 12 duhet të paraqesë 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 11.

Blerjet tuaja gjatë Muajit.

13. Nga kolona 13 "Blerje të përjashtuara dhe me TVSH jo të zbritshme" e Librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale tvsh e blerjeve të përjashtuara dhe me tvsh jo të zbritshme në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 13 të Deklaratës tuaj. Për këto blerje nuk do të bëhet zbritje e TVSH.

14. Nga kolona "Vlera e Tatueshme e Importeve" e Librit tuaj të Blerjeve për muajin, mbliidni totalin e këtyre blerjeve dhe shkruani rezultatin në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 14 të Deklaratës tuaj. TVSH e paguar në import zbritet.

15. Nga kolona "Importe TVSH" e Librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale importe tvsh në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 15 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 15 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 14.

16. Nga kolona "Vlera e tatueshme e blerjeve brenda vendit" e Librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale të vlerës së tatueshme në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 16 të Deklaratës tuaj. Për mallrat e blera nga furnizues vendas që janë regjistruar për TVSH, përfitohet zbritja e TVSH.

17. Nga kolona "TVSH blerje brenda vendit" e Librit tuaj të Blerjeve, mbliidni totalin e këtyre blerjeve dhe paraqitni rezultatin në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 17 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 17 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 16.

18. Nga kolona "Vlera e tatueshme e blerjeve nga fermerët vendas" e Librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve nga fermerët e peregjistruar për TVSH dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale të vlerës së tatueshme në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 18 të Deklaratës tuaj.

19. Nga kolona "TVSH i zbritshëm kompensimi i fermerëve" e Librit tuaj të Blerjeve, mbliidni totalin e këtyre blerjeve dhe paraqitni rezultatin në fund të faqes së këtij libri. Shumën e përfutur vendosni në kutinë 19 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 19 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së kutisë 18 dhe përfitohet zbritja nga TVSH.

Saktësimet

20. Nqs në Deklaratën tuaj të muajit të kaluar keni një tepricë TVSH të zbritshëm, paraqitni atë në kutinë 20. Kjo shumë është treguar në kutinë 24 të Deklaratës tuaj të muajit të kaluar.

21. Nqs vlera e paraqitur në kutinë 20 është mbi 400000 lekë dhe për cdo deklaratë tuaj të 3 muajve të njëpasnjëshme keni një tejkallim të TVSH të zbritshëm (vlera e treguar në kutinë 24) ju mund të paraqesni një kërkesë për Rimbursim të Tepricës së TVSH të zbritshme. Plotësoni Formularin e Kërkesës për Rimbursim me shumën që ju duhet të rimbursoheni. Paraqitni këtë vlerë në kutinë 21 të Deklaratës tuaj.

22. Llogarisni gjendjen e TVSH së zbritshme nga muaji i kaluar duke zbritur nga vlera e kutisë 20, vlerën e kutisë 21 dhe rezultatin paraqitni në kutinë 22.

Totali i TVSH të zbritshëm për Muajin.

23. Llogarisni totalin e TVSH së zbritshëm për muajin, duke mbledhur TVSH e zbritshëm për Importet (kutia 15), TVSH e zbritshëm për Blerjet nga furnizuesit vendas (kutia 17), kompensimi i paguar për blerjet nga fermerët (kutia 19) dhe gjendjen e TVSH të zbritshëm nga muaji i kaluar (kutia 22). Shumën paraqitni në kutinë 23.

Teprica e TVSH të zbritshëm.

24. Nqs Totali i TVSH të zbritshëm për muajin (kutia 23) është më i madh se TVSH i llogaritur për shitjet e muajit (kutia 12), keni një Tepricë TVSH të zbritshëm dhe nuk duhet të bëni asnjë pagesë në këtë muaj. Llogaritni tepricën e tvsh të zbritshëm duke zbritur vlerën e kutisë 12 nga vlera e kutisë 23 dhe paraqitni rezultatin e përfutur në kutinë 24. Nqs vlera e kutisë 12 është më e madhe ose e barabartë me vlerën e kutisë 23 shkruani zero në kutinë 24.

TVSH i detyrueshëm për tu paguar

25. Nqs TVSH i llogaritur për muajin (kutia 12) është më i madh se Totali i TVSH të zbritshëm për muajin (kutia 23), keni tvsh të detyrueshme për tu paguar. Llogarisni TVSH e detyrueshëm për tu paguar duke zbritur vlerën e kutisë 23 nga vlera e kutisë 12 dhe paraqitni rezultatin e përfutur në kutinë 25. Nqs vlera e kutisë 23 është më e madhe ose e barabartë me vlerën e kutisë 12, shkruani zero në kutinë 25.

Plotësoni Deklaratën dhe Paguani TVSH

Deklarata duhet të plotësohet dhe paraqitet nga ju në bankë për pagesë Brenda datës 14 të muajit pasardhës nga muaji i treguar në Deklaratë si periudhë tatimore. Nqs ju keni pagesë për të bërë dhe e bëni këtë pagesë Brenda kësaj date shënoni shumën e kutisë 25 në kutinë 27. Nqs bëhet një pagesë e pjesshme ose një pagesë e vonuar, detyrimit tuaj i shtohen gjoba dhe interesa. Dega e Tatimeve mund t'ju tregojë vlerën që duhet të vendosni në kutinë 26. Mbliidni vlerën e kutisë 25 me atë të kutisë 26 dhe shënoni detyrimin total në kutinë 27. Vendosni datën e plotësimit të Deklaratës, firmosni atë dhe paraqitni në bankë, ku një kopje e kësaj deklarate do t'ju kthehet pas pagesës. Ju duhet të paraqitni në bankë me këtë deklaratë edhe nqs nuk keni ndonjë shumë për të paguar.

Për më shumë informacion lexoni Udhëzuesin e TVSH ose merrni kontakt me Degen e Tatimeve të rrethit tuaj.

[illegible]

U PRANUA
INSPEKTORI
EMER MBIEMER Firma

UDHËZIM
Nr.3, datë 11.1.2008

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003
“PËR AKCIZAT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Pika 2.4 e udhëzimit ndryshohet si vijon:
2.4 Autorizimi i akcizës i lëshohet personit që e kërkon atë njëherë me fillimin e veprimtarisë tregtare dhe është i vlefshëm deri në mbylljen e kësaj veprimtarie, me të paraqitur kërkesën për mbyllje.
2. Pika 2.5 e udhëzimit ndryshohet si vijon:
2.5 Në rastet kur aplikanti nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit dhe të këtij udhëzimi, organi tatimor mund t’i revokojë formularin e autorizimit të akcizës së lëshuar si “tatimpagues akcize i autorizuar”.
3. Pika 3.5 e udhëzimit ndryshohet si vijon:
3.5 Miratimi i magazinës tatimore i lëshohet personit që e kërkon atë, njëherë me fillimin e veprimtarisë tregtare dhe është i vlefshëm deri në mbylljen e kësaj veprimtarie, me të paraqitur kërkesën për mbyllje.
4. Pika 3.9 e udhëzimit ndryshohet si vijon:
3.9 Organi tatimor mund t’i revokojë formularin e miratimit të magazinës tatimore aplikantit, kur magazina tatimore nuk përmbush ndonjë nga kushtet e përcaktuara në paragrafin 3.8 me sipër ose kur aplikanti ka kërkuar miratimin për një operacion që nuk lejohet nga dispozitat e ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, apo të udhëzimit në zbatim të tij.
5. Pika 50.1 e udhëzimit ndryshohet si vijon:
50.1 Rimbursimi i akcizës mund të kërkohej në këto raste:
a) kur sasia e pullave të akcizës është prishur ose kjo sasi bëhet e papërdorshme, përpara se ato të ngjiten ose gjatë procesit të ngjitjes, kur ky veprim kryhet nga një makineri;
b) kur sasia e pullave të akcizës bëhet e pavlefshme për shkak të ndryshimeve në nivelin e akcizës;
c) kur sasia e paketave të cigareve me pulla akcize është e papërdorshme për treg;
d) kur sasia e pijeve alkoolike me pulla që mund të importohet, por nuk mund të shitet në treg dhe është e destinuar për të prodhuar pije të tjera alkoolike në Republikën e Shqipërisë.
6. Në pikën 50.2 të udhëzimit shtohet germa “d” me këtë përmbajtje:
d) Komisioni i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve vërteton nëpërmjet analizave të kryera se sasia e paketave të cigareve me pulla fiskale është e papërdorshme për tregun dhe duhet të asgjësohet, si dhe kërkon rimbursimin e akcizës në bazë të germës “c” të pikës 50.1 të këtij udhëzimi.
7. Në pikën 50.6 të udhëzimit shtohet pika “c” me këtë përmbajtje:
c) kthimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve i sasisë së paketave të cigareve me pulla fiskale, në vijim të miratimit nga Komisioni i ngritur sipas germës “d” të pikës 50.2 për asgjësimin e tyre, kur rimbursimi i akcizës kërkohej në bazë të germës “c” të pikës 50.1 të këtij udhëzimi.
8. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14.000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|----------------------------|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 11.1.2008
 Doli nga shtypi më 11.1.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
 Tiranë, 2008

Çmimi 16 lekë